



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2298/Prot.  
15

Tiranë, më 21.09.2023

V E N D I M

Nr. 68 datë 21.09 2023

**“MIRATIMIN E SHITESËS NË RREGULLOREN E OBJEKTEVE  
SPORTIVE NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 3, gërma a) dhe d), neni 52 pika 1, gërma b), të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsmin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të e RSH”; të Statutit të UST-së, neni 7, pika 3 ,gërma a) dhe d), neni 46, pika 1, gërma j), të Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, të Vendimit të Senatit Akademik nr.68 datë 13.09.2022, të Vendimit të Bordit të Administrimit nr.42 datë 15.09.2022 “Miratimin e rregullores së Objekteve Sportive në Univeristetin e Sporteve të Tiranës”, të Vendimit të Rektoratit nr.79 datë 06.09.2023, të Vendimit të Senatit Akademik nr.100 datë 20.09.2022, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 21.09.2023,

V E N D O S I :

1. Të miratojë shtesën në “Rregulloren e brendshme për funksionimin e fushave dhe ambienteve sportive, në Universitetin e Sporteve të Tiranës” si vijon:

Në Nenin 6, pika 6.2 “Tarifat dhe Oraret”, nënpika 4, ku thuhet:”Oraret sipas grafikut që kompanitë, shoqatat dhe grupet amatore mund të zhvillojnë seancat e tyre pasi kanë lidhur kontratat në *Palestrën e Lojrave Sportive* janë si më poshtë :

*-Dita e hënë deri ditën e premte 17:00-23:00*

Të saktësohet dhe të shtohet paragrafi si vijon:

“Oraret sipas grafikut që kompanitë, shoqatat dhe grupet amatore mund të zhvillojnë seancat e tyre pasi kanë lidhur kontratat për *Ambientet Sportive* janë si më poshtë:

*-Dita e hënë deri ditën e premte 17:00-23:00, si dhe në orare të tjera kur ambientet nuk janë të zëna me procesin mësimor.*

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek transparenca universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

ARTUR ÇOBANI

